



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

Tiranë, më 28.09.2021

NJOFTIM

ULET VIJA E FINANCIMIT PËR MASAT MBËSHTETËSE DIREKTE TË VITIT 2021

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural njofton uljen e vijës së financimit për aplikimet sipas masave mbështetëse të fermerëve dhe sipas listave të shpallura, në përputhje me procedurat e përcaktuara në Udhëzimin Nr. 3 datë 26.02.2021, “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural” i MBZHR dhe MFE, si dhe Urdhrit të Ministrit nr. 331, datë 04.08.2021 , “Për rialokimin e fondit të Programit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për vitin 2021”

Njoftimi mbi uljen e vijës së financimit për “**Listat e Aplikimeve të Kualifikuara**”, të cilat gjenden në faqen zyrtare: www.azhbr.gov.al, për masa mbështetëse direkte, financuar nga Programi Kombëtar, viti 2021.

Agropikat janë në gatishmëri për dhënie informacioni të aplikantëve të cilët janë brenda vijës së financimit.

Më poshtë po ju njoftojmë numrin rendor të aplikantëve si dhe numrin e kodit të aplikimit që përfshihet mbi vijën e financimit.

- **Masa 1:** Tufa bazë e matrikulluar – Vija e financimit ishte ne numrin rendor 1886 për kodin e aplikimit me numër 3408 - Janë përfshirë në fond aplikimet deri në numrin rendor 1902, për kodin e aplikimit me numër 3432.
- **Masa 2:** Parqet me koshere bletësh - Vija e financimit ishte ne numrin rendor 763 për kodin e aplikimit me numër 4940– Janë përfshirë në fond aplikimet deri në numrin rendor 768, për kodin e aplikimit me numër 4969.
- **Masa 3:** Zëvendësim plasmasi në sesa ekzistuese – Vija e financimit ishte ne numrin rendor 588, për kodin e aplikimit me numër 11782- Do të përfshihen në fond aplikimet deri në numrin rendor 593, për kodin e aplikimit me numër 11943.
- **Masa 4:** Mbjellje Bimë Aromatike dhe medicinale – Vija e financimit ishte ne numrin rendor 113, për kodin e aplikimit me numër 1849 - Do të përfshihen në fond aplikimet deri në numrin rendor 116, për kodin e aplikimit me numër 1866.

Fermerët të cilët iu përshihet aplikimi me fond të buxhetit të shtetit në datë **28.09.2021 për masën 3 dhe 4**, kanë afatin e dorëzimit të dokumenteve shtesë deri në datë **13.10.2021**. Dorëzimi përtej këtij afati do të rezultojë me skualifikim të aplikimit.